



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6985 prot.

Himarë, më 15.09.2025

VENDIM

Nr. 47, Datë 13/09/2025

**"PER MIRATIMIN E PROJEKT-PROPOZIMIT PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE
LEVIZESE PER INDIVIDË
DHE FAMILJE NË NEVOJË NË BASHKINË HIMARË"**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2; nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b"; nenit 24; nenit 54, shkronja "k"; dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e dates 13.09.2025, pasi shqyrtoi materialin e sjellë nga drejtoria e çështjeve sociale, arsimit dhe rinisë e miratoi me 14 (katërmëdhjetë) vota pro, 1 (një) kundër, 0 (zero) abstenim dhe si më poshtë:

VENDOSI:

1. Miratimin e projekt-propozimit për ofrimin e shërbimeve levizëse për individë dhe familje në nevojë në Bashkinë Himarë, i përfshirë në Planin Social Vendor. Dokumenti bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare për zbatimin e projekt-propozimit do të perballohen nga buxheti vjetor i Bashkisë Himarë dhe fondet e dedikuara nga buxheti i shtetit. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të mbështesë bashkinë në vitin e parë me 90% të kostos totale të projektit, ndërsa bashkia do të perballojë 10%. Në vitin e dytë, Ministria do të kontribuojë 60% dhe bashkia 40%, dhe në vitin e tretë Ministria 30%, ndërsa bashkia mbulon pjesën tjetër të kostos së projektit, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3. Ngarkohen Drejtoria e Çështjeve Sociale, Arsimit dhe Rinisë, si dhe Drejtoria e Financës dhe e Planifikimit sipas objektivave dhe afateve të parashikuara.

Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore".

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

